



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### BASHKIA KORÇË

Korçë, më datë 30/11/2022

#### Proces-verbal nr. 1

Bazuar në LIGJIN Nr 139/ 2015, neni 3, pika “dh”, në datën 21 nëntor – 25 nëntor 2022 në kuadrin e procesit të “Buxhetimit me Pjesëmarrje”, për të diskutuar lidhur me kërkesa dhe shqetësime të kryetarëve dhe banorëve të fshatrave u zhvilluan takime të njëpasnjëshme me kryetarët e Njësive Administrative të Bashkisë Korçë si edhe me banorë të çdo njësie.

Pjesë e panelit të diskutimit ishin z. Sotiraq Filo Kryetar Bashkia Korçë, Kletion Kita Zv. Kryetar Bashkia Korçë, Thanas Tona Zv. Kryetar Bashkia Korçë, Soniel Prifti Drejtor i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Korçë, Ilir Dinellari Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike.

Fjalën e mori i pari z. Sotiraq Filo, i cili listoi disa nga investimet e mëdha të realizuara por edhe në proces në Njësiti Administrative. Mes tyre përmendi projektet: ndërtimi i ujësjellsave të rinjë në disa fshatra të Bashkisë Korçë, ndërhyrjet e njëpasnjëshme në rrugët e parcelave në të gjithë fshatrat e Bashkisë Korçë, ndriçimin public dhe rehabilitimin e rrjetit të brendshëm rrugor në fshatrat e Bashkisë Korçë etj. Në vazhdim ai foli edhe për rëndësinë e marrjes së mendimeve të kryetarëve dhe banorëve të fshatrave për investimet gjatë vitit të ardhshëm në mënyrë që t’u jepet prioritet atyre ndërhyrjeve që vetë ata i shohin si më emergjente.

Pasi u njohën me shpjegimet përkatëse për “Buxhetimin me Pjesëmarrje” dhe mundësinë që ata kanë për të zgjedhur vetë ato ndërhyrje që bashkia duhet t’i shohë me përparësi, kryepleqtë patën mundësinë për të parashtruar kërkesat e tyre dhe për të vendosur prioritetet sa i takon fokusit të investimeve të Bashkisë Korçë për vitin 2023. Kërkesat e tyre u mbajtën shënim paralelisht dhe të detajuara sipas grafikut të takimeve të zhvilluara më poshtë.

### **Takimet e zhvilluara:**

- 21 nëntor - Njësia Administrative Bulgarec
- 22 nëntor - Njësia Administrative Vithkuq
- 23 nëntor - Njësia Administrative Voskop
- 23 nëntor - Njësia Administrative Mollaj
- 24 nëntor - Njësia Administrative Voskopoje dhe Lekas
- 25 nëntor - Njësia Administrative Drenovë

Bazuar në kërkesat e ngritura nga kryetarët dhe banorët e fshatrave u listuan nevojat e tyre si më poshtë:

### **BULGAREC**

- **Fshati Belorta:** Mungesa e ujit për vaditjen e prodhimeve në parcela
- **Fshati Barç:** Asfaltimi i rrugëve në dy lagjet e zonës së xhamisë
- **Fshati Çiflig:** Riparimi i shkollës, asfaltimi i rrugëve të fshatit
- **Fshati Bulgarec:** Asfaltim i rrugës së vjetër të fshatit, ndërhyrje në rrjetin e kanalizimeve.
- **Fshati Kuç i Zi:** Mungesa e ujit të pijshëm dhe ndriçimit
- **Fshati Neviçisht:** Vendosja e një prite midis dy përrenjëve që kemi në fshat
- **Fshati Biranj:** Problem uji për vaditje
- **Fshati Malavec:** Kanalizimi i ujërave të zeza
- **Fshati Melçan:** Mungesa e ujësjellësit
- **Fshati Lumalas:** Kanalizimi i ujërave të zeza
- **Fshati Porodinë:** Pastrimi i përroit brenda fshatit

**Në fshatin Belorta (XXX)** Mungesa e ujit për vaditje është një nga problemet më shqetësuese për ne, ndaj kërkojmë një zjidhje të menjëhershme. Përsa i përket ujësjellësit banorët janë dakord që të administrohet nga UKKO.

**Në fshatin Barç (XXX)** Në fshatin tonë duhet të ndërhyet për asfaltim në dy lagje tek zona e xhamisë. Gjithashtu kërkojmë edhe mirëmbajtjen e rrugëve nga lumi. Faleminderit!

**Në fshatin Çiflig (XXX)** Problemi ynë kryesor mbetet rruga e fshatit, e cila ka nevojë për ndërhyrje, janë rreth 250 m asfalt. Faleminderit që na bëni pjesë të këtyre takimeve! Ka akoma shumë punë për të bërë por shpresojmë që me mbështetjen tuaj të vazhdueshme do t'i zgjidhim problemet që kemi.

**Në fshatin Bulgarec (XXX)** Investimet e bëra në këtë fshat kanë qënë brenda pritshmërive tona dhe ne jemi të kënaqur. Prioritet për në vazhdim është infrastruktura rrugore. Ndërhyrje në rrjetin e kanalizimeve, si edhe ndërtimi i një fushe sporti për të rinjtë e fshatit.

**Në fshatin Kuç i Zi (XXX)** Një nga problemet tona më shqetësues është mungesa e ujit të pijshëm. Kemi probleme gjithashtu me ndriçimin. Do të donim ta merrnit parasysht kërkesën tonë për të mbjellë 20 rrënjë blir tek varrezat.

**Në fshatin Neviçisht (XXX)** Ju falenderojmë për asfaltimin e rrugës që u bë në fshatin tonë. Është e kuptueshme që në çdo fshat ka shumë punë për të bërë dhe nuk është e lehtë që çdo gjë të zgjidhet shumë shpejt por ne jemi të kënaqur me ato investime që janë bërë deri më tani. Kërkesa jonë është vendosja e një prite midis dy përrrenjëve që kemi në fshat. Gjithashtu duam edhe 3 kazanë për mbeturinat.

**Në fshatin Biranj (XXX)** Faleminderit që na bëni pjesë të këtyre takimeve. Ne kërkojmë rrethimin e varrezave të fshatit si edhe betonimin e kanaleve anësorë të rrugës që u asfaltua. Kemi gjithashtu problematika edhe me ujin për vaditje.

**Në fshatin Shamoll (XXX)** Jemi shumë të kënaqur me të gjitha investimet që janë bërë në fshatin tonë. Ju urojme suksese dhe punë të mbarë në vazhdim.

**Në fshatin Malavec (XXX)** Kanalizimi i ujërave të zeza në hyrje të fshatit është problemi ynë më madhor. Ju lutem merreni parasysht kërkesën tonë që tek varrezat e fshatit duhet të ketë ujë patjetër sepse është e vetmja zonë me probleme.

**Në fshatin Melçan (XXX)** Është bërë një punë shumë e mirë me veshjen e kanalit. Problem mbetet ujësjellësi dhe ujërat e zeza. Gjithashtu kërkojmë asfaltimin e rrugës që u bë me çakull para disa kohësh.

**Në fshatin Lumalas (XXX)** Lulishtja që u bë e re nuk pastrohet, ju lutem dërgoni punëtorët që ta sistemojnë dhe pastrojnë. Kemi gjithashtu probleme edhe me kanalizimin e ujërave të zeza. Shpresojmë që kërkesat tona të merren parasysht.

**Në fshatin Porodinë** Duhet të fillojë sa më shpejt puna për pastrimin e përroit brenda fshatit. Problem tjetër është edhe mungesa e kazanëve të mbeturinave.

## **VITHKUQ**

- **Fshati Vithkuq:** Probleme me kanalet kullues dhe vaditës, sistemimi i rrugëve me kalldrëm, sistemimi i kanalizimeve
- **Fshati Lubonjë:** Përfundim i rrugës që lidh fshatin Lubonjë me Ersekën
- **Fshati Leshnjë:** Sistemim i rrjetit të ujërave të zeza
- **Fshati Shtyllë:** Sistemim i varrezave të fshatit

**Në fshatin Vithkuq (XXX)** Vazhdojmë të kemi probleme me kanalet kullues dhe vaditës, të cilat mbeten shqetësime për banorët. I domosdoshëm është ndërtimi i një muri mbajtës në Saraç. Po ashtu sistemimi i rrugëve me kalldrëm është një tjetër kërkesë e jona. E domosdoshme është ndërhyrja tek shkolla e fshatit, në dy klasat e saj, të cilat kanë nevojë për suvatim dhe vendosjen e pllakave.

**Në fshatin Lubonjë (XXX)** Rruga që lidh fshatin tonë me Kolonjën kërkon një sistemim në një gjatësi prej 500 metrash, pasi kjo e bën më të lehtë lidhjen me këtë bashki. Kërkojmë që shërbimi ujësjellës të administrohet nga UKKO për të pasur një menaxhim më të mirë.

**Në fshatin Leshnjë (XXX)** Është bërë një punë shumë e mirë nga Bordi i Kullimit për sistemimin e lumit. Jemi shumë të kënaqur edhe me rrjetin e ujit të pijshëm, por nuk ka ujë në varreza, ju lutem të ndërhyet për këtë kërkesë. Një problem tjetër në fshatin tonë mbetet sistemimi i ujërave të zeza. Kërkojmë një ndërhyrje të menjëhershme sepse është një problem shqetësues për të gjithë banorët.

**Në fshatin Goskovë Lart: (XXX)** Sistemimi i rrugëve brenda fshatit.

## **VOSKOP**

- **Fshati Voskop:** Asfaltimi i rrugës së fshatit, ujërat e zeza
- **Fshati Dërsnik:** Ndërhyrje në rrugën Polenë-Dërsnik, asfaltimi i rrugëve brenda fshatit
- **Fshati Polenë:** Betonizimi i përroit të fshatit
- **Fshati Goskovë:** Zgjerim i rrugëve të fshatit, sistemim i rrugës me stabilizant

**Në fshatin Voskop (XXX)** Problemi kryesor për banorët e fshatit është asfaltimi i rrugës, e cila është amortizuar, si dhe sistemimi i ujërave të zeza në fshat mbetet një nga shqetësimet tona kryesore.

**Në fshati Dërsnik (XXX)** Jemi shumë falenderues për investimet e bëra në fshatin tonë, por kërkojmë asfaltimin e rrugës lidhëse mes Polenës dhe Dërsnikut, si dhe sistemimin e rrugëve të brendshme të fshatit. Një punë e mirë është bërë në çakullimin e rrugëve të parcelave që ishte një prej kërkesave tona vitin e kaluar.

**Në fshatin Polenë (XXX)** Rrugët e parcelave falë ndërhyrjeve që ka bërë bashkia kanë qënë në gjendje mjaft të mirë dhe na kanë ndihmuar shumë në punët e bujqësisë. E shohim të nevojshme vendosjen e një saraçineske tek uji që shërben për vaditje dhe betonizimin e përroit të fshatit. Sistemimi i rrugës nga përroi deri tek lumi është i nevojshëm për ne përmes një trotuari për këmbësorët.

**Në fshatin Goskovë Lart: (XXX)** Rrugët e fshatit Goskovë lart janë me një kalim, ndaj kërkojmë shtimin e tombinove për të bërë të mundur zgjerimin e tyre. Nga ana tjetër e nevojshme është sistemimi i rrugëve brenda fshatit që kanë nevojë për ndërhyrje.

## **MOLLAJ**

- **Fshati Kamenicë:** Ndërhyrje për rikonstruksionin e ambulancës së fshatit
- **Fshati Dvoran:** Kushte më të mira për fëmijët në shkolla

**Në fshatin Kamenicë (XXX)** Punën në fushë këtë sezon e kemi pasur më të lehtë për shkak se rrugët e parcelave janë të gjitha të sistemuara. Kërkesa jonë është ndërhyrja tek ambulanca e fshatit pasi kushtet nuk janë të përshtatshme. Gjithashtu kemi nevojë për shtimin e koshave të mbeturinave.

**Në fshatin Dvoran (XXX):** Kërkesa jonë në lidhje me investimet konsiston në ndërhyrjet tek shkolla e fshatit, kryesisht tek tualetet që për momentin po përdoren nga të gjitha moshat. Jam i sigurt se kjo kërkesë do të merret parasysh. Faleminderit për gjithë punën që është bërë deri më tani!

**Në fshatin Pulahë (XXX)** Faleminderit shumë për të gjitha investimet e realizuara në fshatin tonë përgjatë këtij viti. Jemi shumë të kënaqur!

## **VOSKOPOJË DHE LEKAS**

- **Fshati Voskopoje:** Ndërhyrje në rrugët e kalldrëmta
- **Fshati Lavdar:** Asfaltim i rrugës Voskop-Lavdar, mungesa e qendrës shëndetësore
- **Fshati Gjonmadh:** Ndërhyrje në sistemimin e ujërave të zeza
- **Fshati Lekas:** Sistemimi i rrugës që lidh fshatin Lekas me Tudasin
- **Fshati Shkozan:** Ndërhyrje për sistemimin e rrugës që lidh fshatin Shkozan me rrugën kryesore

**Në fshatin Voskopoje (XXX)** Një lagje në hyrje të fshatit tonë ka nevojë për shumë investim. E nevojshme është çakullimi i rrugëve dhe shtrimi me kalldrëm. Një problem tjetër është lumi i fshatit përgjatë rrjedhës së tij në lagjen Xega ka shumë prurje, ndaj duhet shtim i argjinaturës. Pastrimi i mbeturinave nga firma të bëhet më shpesh në fshat.

**Në fshatin Lavdar (XXX)** Kërkojmë nga bashkia të ndërhyjë për asfaltimin e rrugës kryesore të fshatit. Mungesa e qendrës shëndetësore mbetet problem për ne. Gjithashtu duhet të gjendet një zgjidhje për ujin, pasi është i papijshëm.

**Në fshatin Gjonmadh:(XXX)** Në fshatin kemi probleme me kanalizimet e ujërave të zeza. Gjithashtu i nevojshëm është pastrimi i dy përrrenjve të fshatit dhe riparimi i burimit jashtë fshatit.

**Në fshatin Lekas: (XXX)** Ajo që kërkojmë si fshat është ndërtimi i një prite për sistemimin e përroit. Probleme kemi me linjën e furnizimit me energji elektrike. E nevojshme është ndërhyrja për sistemimin e rrugës që lidh fshatin Lekas me Tudasin, pasi është e amortizuar.

**Në fshatin Shkozan:(XXX)** Sistemimi i rrugës që lidh fshatin tonë me rrugën kryesore është i nevojshëm. Gjithashtu do të ishte mirë të vendosen tombino tek dy përrrenjtë e fshatit.

## **DRENOVË**

- **Fshati Turan:** Rehabilitim i rrjetit të ujërave të zeza të fshatit dhe zgjidhja e ujit për vaditjen e parcelave. Riparim i rrugëve të brendshme të fshatit me asfalt

- **Fshati Drenovë:** Ndërhyrje për kanalizimin e ujërave
- **Fshati Qatrom:** Pastrimi i kanaleve vaditëse dhe anësore të fshatit.
- **Fshati Mborje:** Ndërhyrje në infrastrukturën e rrugëve
- **Fshati Ravonik:** Shtimi i ndriçuesve publikë në fshat. Plotësimi i rrjetit të kanalizimeve dhe asfaltim në rrugën hyrëse të fshatit

**Në fshatin Turan (XXX)** Faleminderit për ndërhyrjen e bërë për sistemimin e rrjetit të ujërave të zeza në fshat. Kërkojmë nga ju të shtohen ambientet çlodhëse në qendër të fshatit dhe ato për moshën e tretë. Gjithashtu e nevojshme është ndërhyrja tek rrugët dytësore të fshatit, teksa problem mbetet edhe vaditja e tokave bujqësore.

**Në fshatin Drenovë (XXX)** Jemi falendues për investimet që janë bërë në fshatin tonë. Momentalisht lagjja lart ka mungesë të theksuar të ndriçimit publik. Gjithashtu kërkojmë nga ana e bashkisë të përfundojë punën e nisur me rrjetin e kanalizimeve dhe të zgjidhë administrimin e mbetjeve që janë një ndër problemeve kryesore në fshat.

**Në fshatin Qatrom (XXX)** Jemi të kënaqur më disa ndërhyrje që janë bërë në fshatin tonë, por kërkojmë pastrimin e kanaleve që janë bllokuar nga mbeturinat. Ndërtimi i një këndi sportiv në fshat është një kërkesë e vazhdueshme e të rinjve për të kaluar kohë në mënyrë aktiv. Besoj se këto problematika do të gjejnë zgjidhje sa më pare.

**Në fshatin Mborje (XXX)** Faleminderit për punën e bërë në fshatin tonë, por kemi ende kërkesa edhe për këtë vit. E nevojshme është ndërhyrja në infrastrukturë dhe sistemimi i qendrës së fshatit.

**Në fshatin Ravonik (XXX)** Në fshatin tonë kemi mungesë të ndriçimit publik dhe koshave për grumbullimin e mbeturinave. E nevojshme është edhe ndërtimi i një tualeti publik në qendër të fshatit. Kanë ngelur ende rrugë të paasfaltuara në fshati por më kryesore është riparimi i rrugës kryesore të fshatit.